



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA
OPSTINA PEC



REFERENCE :	
NGA / OD / FROM:	Z. Nasret Hajrizi, Drejtor për zhvillim ekonomik - KK. Pejë
TEMA / SUBJEKAT / SUBJECT:	Thirrje publike për subvencionimin e OJQ për përkrahje në zhvillimin e festivalit turistik "Peja Outdoor Festival"
DATE:	29.04.2025

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare që veprojnë në Komunën e Pejës të aplikojnë për mbështetje financiare me projekt që të kontribuojnë në promovimin dhe zhvillimin e qytetit të Pejës si destinacion turistik të aventurës e kjo përmes përkrahjes së organizimit të festivalit "Peja Outdoor Festival".

Ndër prioritetet e kësaj thirrje janë: Rritja e bashkëpunimit në organizimin e festivalit tradicional, promovimi i aktiviteteve në natyrë, përfshirja e akterve që ofrojnë aktivitete në natyrë në organizimin e festivalit, promovimin e Pejës si destinacion i turizmit të aventurës, promovimi dhe dialogu për zhvillim të qëndrueshëm, tërheqja e vizitorve nga Kosova dhe rajoni për ta vizituar Pejën gjatë festivalit, edukimi dhe promovimi i aktiviteteve në natyrë me shkolle si mundësi e ngritjes së mirëqenjes së banorëve.

Që festivali të arrijë prioritetet e saj në organizim OJQ duhet që:

- Të zhvillojë programin për festivalin. OJQ duhet të prezantojë një skenarë të zhvillimit të aktivitetit sipas formatit të bashkëpunimit dhe të dëshmojë se kanë organizuar apo kanë qenë pjesë të festivaleve më heret apo ngjarje të spektrit të njejtë.
- Të zhvillojë dhe prezantojë programin për promovimin e aktiviteteve në natyrë.
- Të dëshmojë përfshirjen e sa më shumë akterve që ofrojnë aktivitete në natyrë.
- Ta prezantojë një skenar për promovimin e Pejës si destinacion i turizmit të aventurës.
- Të kontribuojë në organizimin e neteve argëtuese me muzikë.
- Të organizojë dialog përmes paneleve të diskutimi me institucione dhe akterë tjerë relevantë që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

- Të promovoj festivalin në nivel kombëtar dhe rajonal me qëllim të ngritjes së numrit të vizitorve.
- Të ofroj lidhje me të gjithë popullatën e Pejës e më gjërë për ti promovuar aktivitetet më natyrë si mundësi për mirëqenje më të mirë.

Kush mund të aplikojë:

OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, me seli në Pejë, të profilizuara në fushën e sportit dhe rekreacionit në natyrë, me përvojë të dëshmuar në sektorin e vet dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme.

Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të

- Të janë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës.
- Selia e organizatës duhet të jetë në Komunën e Pejës.
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës.
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt propozimit.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit, përkatësisht përfaqësuesve të aplikantit dhe institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore.
- Në rast që OJQ-ja ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.

Dokumentet obligative për aplikim për OJQ:

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha formularët e aplikimit dhe anekset e detyrueshme si ne vijim:

- Formulari i Aplikacionit për Projekt për OJQ (Dokument i thirrjes publike);
- Formulari i Propozim Buxhetit (Dokument i thirrjes publike);
- Formulari i deklaratës mbi projektet e financuara nga burimet publike
- Formular i deklaratës së partneritetit, nëse aplikohet (Dokument i thirrjes publike);
- Certifikata e regjistrimit dhe certifikata e numrit fiskal e OJQ-së (lëshuar nga Departamenti i OJQ-ve, ATK);
- Vërtetimi që nuk ka obligime financiare ndaj ATK (dokumenti i lëshuar nga ATK)
- Konfirmimin mbi llogarinë bankare të lëshuar nga banka përkatëse;

- Lista e projekteve që ndërlidhen me temën e thirrjes publike (document i OJQ që mund të dëshmohet me listën e projekteve dhe fotografi)

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

1. Vlerësimi administrativ

Që identifikon nëse aplikanti ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

2. Vlerësimi përmbajtësor

- Aplikuesi është i profilizuar në organizmin e festivaleve;
- Aplikuesi ka përgatitjen dhe kapacitetet e nevojshme për zbatimin e projektit;
- Aplikuesi ka aplikuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e programit në vitet paraqike;
- Projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;
- Projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje;
- Aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Kostot e projekt-propozimit janë reale me rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Shpenzimet e papranueshme

- Gjjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore.
- Shpenzimet e interesit për borxhin.
- Investimet në kapital apo kredi për organizata të tjera apo individ.
- Pagesa e bonuseve për punonjësit.
- Detyrimet bankare për administrimin e llogarive, tarifat për transferet financiare.
- Donacionet bamirëse.
- Pagesa e qirasë së zyreve për veprimtarinë e organizatave ose individëve.

- Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit.

Aplikimi:

Propozimet duhet të dorëzohen në formë fizike dhe të protokolluara në sportelet e komunës së Pejës. Afati për aplikim hapet me **30.Prill.2025** dhe afati i fundit për aplikim përfundon me datën **15 Maj 2025**.

Buxheti

Buxheti i ndarë për realizmin e këtij festivali është **20.000 Euro (Njëzet mij euro)**

Aftai i realizimit

Aftai për realizmin e këtij festivali duke përfshirë të gjithë aktivitetet e organizmit dhe raportimin duhet të jetë nga **23 Maj** deri në **27 Qershorë**. Festivali do të organizohet me data **13** deri **15 Qershorë**.